

## Në Prizren festohet Dita e gjimnazi "Loyola" Gjimnazi "Loyola" është model i edukimit evropian në Kosovë

Në këtë shkollë aktualisht mësimet i vijnë rreth 550 nxënës, suksesi të cilëve është mbi nivelin e të gjitha shkollave të mesme të Prizrenit

Me një manifestim rasti, i cili është tradicional për çdo pranverë, në Prizren të enjten është shënuar dita e shkollës së parë të mesme private në Kosovën e pasluftës. Në katër vjetorin e themelimit të gjimnazit klasik gjerman "Loyola", me moton "Dita e dyerve të hapura", kanë filluar manifestimet ku pos nxënësve dhe mësimit të kësaj shkolle ishin të pranishëm edhe zyrtarë arsimor lokal me në krye Florim Metaj, drejtor komunal për Arsim, pastaj përfaqësues nga KFOR-i në Prizren, përfaqësues të komuniteteve fetare, prindër e mysafirë të shumë të tjerë. Sipas drejtuesve të kësaj shkolle, e cila funksionon për mrekulli tash e katër vite në qytetin e Prizrenit dhe ku mësimet i vijnë shumë nxënës nga ky qytet dhe komunat e rajonit të Prizrenit, dita e dyerve të hapura shënon përvjetorin e themelimit të Kompleksit shkollor "Asociation Loyola Gymnasium", i cili në fakt është institucioni i parë privat i këtij lloji në tërë Kosovën. Duke folë për punën e kësaj shkolle, ku rezultatet konkrete, sidomos në

procesin mësimor, janë shumë evidente dhe paraqesin modelin e shkollimit evropian, drejtori i kësaj shkolle, Walter Happel, ka thënë se brenda një kohe të shkurtër, në këtë vatrë diturie janë shënuar rezultate konkrete, si bie fjala kalimi i testit të gjuhës gjermane "C-1" nga nxënësit e këtushëm, të cilëve kjo iu hap rrugën atyre për studime kudo në shkollat dhe institucionet ku mësohet në gjuhën gjermane, ndërsa zëvendësdrejtori Mark Gojani, ka theksuar se hapja e kësaj shkolle ka sjellë përvoja të reja në edukim, të cilat janë kombinuar me përvojat e këtushme, duke çuar në konstatimin se këtu punohet njësoj sikur edhe në vendet evropiane. Në këtë gjimnaz aktualisht i vijnë mësimet rreth 550 nxënës, dhe është i tipit konviktor, fakt ky që jep mundësinë që pos nxënësve nga qytetit i Prizrenit, mësimet t'i ndjekin edhe shumë nxënës nga rajoni i Prizrenit si dhe nga vise të tjera të Kosovës, ndërkaq që këtu janë të përfshirë nxënës nga shkolla e mesme e ultë edhe ajo e mesme e lartë.

**R. Reshitaj**